TIRANA FILM INSTITUTE

TIRANA INTERNATIONAL FILM FESTIVAL

Mirë se vini në edicionin e 24-t të TIRANA INTERNATIONAL FILM FESTIVAL 2026

Tirana International Film Festival (TIFF) prezanton me krenari programin e edicionit të tij të 24-t, i cili do të zhvillohet nga **21–27 shtator 2026 në Tiranë**.

I themeluar në vitin 2003, TIFF është shndërruar në një nga ngjarjet më të rëndësishme kulturore në Evropën Juglindore dhe është ndër festivalet kryesore të filmit në botë. Festivali gëzon statusin **Oscar® Qualifying** për kategorinë e Filmit të Shkurtër më të Mirë dhe **Student Academy Award®**. TIFF njihet gjithashtu nga **European Film Academy** si festival i kualifikuar për **European Film Awards (EFA)**, duke e vendosur Shqipërinë në hartën ndërkombëtare të kinemasë.

Edicioni i këtij viti prezantohet nën temën **"Bring it back! HUMANOGRAPHY"**, duke i ftuar publikut të reflektojë mbi historitë njerëzore, emocionet dhe përvojat përmes gjuhës së kinemasë.

Një program ndërkombëtar i larmishëm

Programi konkurrues përmban një përzgjedhje të pasur prej 230 filmash të metrazhit të gjatë dhe të shkurtër nga rreth 70 vende të botës.

Konkurrimi i filmave të gjatë përfshin:

- PerspecTIFF (Filma të gjatë debutues)
- Dokumentarë

Programi i filmave të shkurtër përfshin:

- Live Action
- Animacion
- Dokumentarë
- Video Art & Eksperimental
- Filma Studentorë
- Balkan Shorts
- In Albanian Shorts

Përveç tyre, filmat ne konkurim ne kategorinë **PANORAMA** të TIFF ofrojnë programe tematike si Generations, New World, Divergent Minds, Parade, si dhe një program të dedikuar AI 3.0, i cili eksploron format e reja dhe në zhvillim të rrëfimit audiovizual.

Programe për audiencat e reja – TIFF vijon angazhimin e tij ndaj edukimit përmes filmit me programin KIDs & TEENs, i cili ofron shfaqje të kuruara posaçërisht për fëmijë dhe

adoleshentë, duke i nxitur ata të marrin pjesë aktivisht përmes votimit dhe aktiviteteve edukative.

SPECIAL PROGRAMS

Një nga pikat kulmore të TIFF 2026 është **RetrospecTIFF: Tribute to Luchino Visconti**, në nderim të një prej regjisorëve më me ndikim të kinemasë evropiane. Publiku do të ketë mundësinë të rikthehet te kryevepra si *Obsession* (1943), *Rocco and His Brothers* (1960) dhe *The Innocent* (1976).

Festivali prezanton gjithashtu:

- **Focus on North Macedonia**, që sjell vepra bashkëkohore të regjisorëve kryesorë, përfshirë Teona Strugar Mitevska dhe Milcho Manchevski.
- **LIFE IS SHORT Swiss Films**, zhvilluar në bashkëpunim me Swiss Films, me një përzgjedhje të kuruar të filmave më të mirë të shkurtër zviceranë, artistikë dhe të animuar, të viteve të fundit.
- **Dora García Video Arts 2001–2024** – Veprat e saj ndërthurin fiksionin dhe realitetin deri në pikën e konfuzionit, duke krijuar situata unike, njëkohësisht intelektuale dhe lozonjare, të cilat mbështeten në pjesëmarrjen aktive dhe, ndonjëherë, të detyrueshme të publikut në krijimin, aktivizimin ose shkatërrimin e veprës. Ajo përfaqësoi Spanjën në Bienalen e 54-t të Venecias në vitin 2011.
- **StudenTIFF**, një përmbledhje premierë e punëve të fundit dhe projekteve të diplomës së studentëve të Universitetit të Arteve të Shqipërisë dhe Universitetit të Prishtinës, Kosovë.

SPECIAL SCREENINGS

Pas **ceremonisë së hapjes**, më 21 shtator, edicioni i 24-t i TIFF do të nisë zyrtarisht me premierën kombëtare të filmit ***Mother***, nga regjisorja e vlerësuar me çmime nga Maqedonia e Veriut, **Teona Strugar Mitevska**, që pati premierën botërore në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit të Venecias 2025.

Filmi është një version i fiksionalizuar i historisë se si një murgeshë u shndërrua në ikonë fetare, duke rrëfyer historinë e personit real pas mitit të Nënë Terezës.

Filma të tjerë do të pasojnë në kuadër të këtyre shfaqjeve speciale me premiera botërore dhe kombëtare, si:

- **Shame and Money** nga Visar Morina, fitues i **Grand Jury Prize** në Sundance Film Festival 2026.
- **The Bow and the Brush** nga Raphaëlle Régnier, Francë, 2026, Dokumentar.
- **Live a Little** nga Fanny Ovesen | Suedi, Norvegji, Danimarkë | 2024 | Dramë

- **Made In ALBANIAn** – Premiera kombëtare të filmave më të rinj të prodhuar në Shqipëri dhe Kosovë, në gjuhën shqipe.
- **Filmi i mbylljes:** Mimoza Llastica nga Xhanfise Keko, Shqipëri (1973) – Premierë Botërore e versionit të restauruar në 4K, në bashkëpunim me *AQSHF.*

INDUSTRY EVENTS & Professional Development

Përkrah shfaqjeve, TIFF 2026 ofron një komponent të fuqishëm të industrisë, i cili synon të mbështesë kineastët dhe talentet e reja.

Pikat kryesore përfshijnë:

- **5th Screenplay ContesTIFF**, një platformë për prezantimin dhe zhvillimin e skenarëve, që lidh projektet me mundësi financimi, prodhimi dhe shpërndarjeje.
- **Masterclass** me regjisoren e vlerësuar me çmime **Teona Strugar Mitevska** dhe producenten **Labina Mitevska**.
- **Workshop** animacioni për **fëmijë dhe adoleshentë,** i udhëhequr nga artistët e njohur ndërkombëtarisht **Ana Nedeljković** dhe **Nikola Majdak**, në bashkëpunim me **TUMO Center for Creative Technologies**.
- Ekspozitë fotografike në ambient të hapur, me imazhe arkivore nga kinemaja, nga Archivio dell'Immagine i Centro Cinema di Cesena, Itali.
- **TIFForum:** Bring it back... HUMANOGRAPHY

JURY

Kemi nderin të prezantojmë juritë ndërkombëtare dhe kombëtare të këtij edicioni, të përbëra nga emra të njohur në fushat e regjisurës, produksionit, shpërndarjes, aktrimit, animacionit, mësimdhënies dhe industrisë së filmit, si:

Alina Gorlova, regjisore dokumentarësh, producente dhe artiste vizuale (Ukrainë); **Hoda Taheri**, regjisore dhe artiste vizuale (Iran); **Nayra Sanz Fuentes**, regjisore, skenariste dhe producente (Spanjë); **More Raça**, skenariste, regjisore dhe studiuese filmi (Kosovë); **Thelyia Petraki**, regjisore dhe skenariste (Greqi); **Fatlume Bunjaku**, aktore (Kosovë); **John Canciani**, kurator filmi, drejtor artistik festivalesh (Skoci, Itali, Zvicër); **Nikola Majdak**, animator, regjisor dhe pedagog (Serbi); **Giacomo Abbruzzese**, regjisor dhe skenarist (Itali, Francë); **Ivan Bakrač**, regjisor dhe skenarist (Mali i Zi); **Jane Kortoshev**, producente (Maqedonia e Veriut); **Bruno Carnide**, kineast, drejtor festivali, anëtar i Academy of Motion Picture Arts and Sciences, SHBA (Portugali); **Adam Selo**, distributor dhe producent (Itali); **Fani Zguro**, artist vizual (Shqipëri, Itali, Gjermani); **Nik Xhelilaj**, aktor (Shqipëri, Turqi, Gjermani).

Nga Shqipëria: **Dritan Huqi**, producent; **Dionis Papadhimitri**, kineast; **Evi Gjoni**, regjisore; **Renis Hyka**, kineast dhe shkrimtar; **Dionis Prifti**, regjisor dhe shkrimtar; **Klaudia Pashnjari**,

regjisore dhe videografe; **Kristina Rushiti**, regjisore dhe skenariste; **Ardian Isufi**, artist vizual dhe kurator; **Merisa Hasrama**, artiste vizuale; **Noel Myrtezaj**, artist vizual.

Ceremonia e mbylljes dhe ndarjes së çmimeve do të zhvillohet më **27 shtator, në orën 20:00**, në **Kinema Millennium**.

VENUES

Shfaqjet dhe aktivitetet e edicionit të 24-t të TIFF 2026 do të zhvillohen në pika të ndryshme në Tiranë, përfshirë:

- Millennium Cinema
- Agimi Art Center
- Kino Piramida
- Vila 31 x Art Explora
- Kinema Maks Velo
- Tunèl Terrace

TIFF in Numbers

Sot, TIFF tërheq fizikisht dhe online më shumë se 30,000 vizitorë çdo vit, merr rreth 3,500 aplikime filmash nga 120 vende dhe shfaq mbi 250 filma çdo vit, duke e bërë atë një nga ngjarjet kulturore më të rëndësishme në rajon.

Projektet e dorëzuara

- **3,319** projekte gjithsej
- 3,228 filma
- 91 skenarë
- **120** vende

Konkursi

- **179** filma gjithsej
- 12 filma të gjatë
- 167 filma të shkurtër
- 12 projekte skenarësh

Jashtë konkurrimit

- **50** filma gjithsej
- 15 filma të gjatë
- 35 filma të shkurtër

TIRANA FILM INSTITUTE

TIRANA INTERNATIONAL FILM FESTIVAL

Në këtë edicion të 24-t do të shfaqen **229 filma, 27 filma të gjatë dhe 202 filma të shkurtër nga 71 vende**. Të gjithë janë premiera botërore, ndërkombëtare, rajonale ose kombëtare.

INFO

Të gjithë ata që janë të interesuar të marrin pjesë në aktivitetet dhe premierat kombëtare të edicionit të 24-t të Tirana International Film Festival 2026, ftohen të plotësojnë formularin e AKREDITIMIT:

http://tiranafilmfest.org/accreditation

Për më shumë informacion mund të vizitoni faqen tonë të internetit, ku mund të gjeni detaje mbi Programin Ditor, Eventet, Jurinë, Çmimet dhe Press Kit.

RRJETET SOCIALE

- Facebook: TiranaFilmFest
- Instagram: @tiranafilmfest
- X (Twitter): @TiranaFilmFest
- YouTube: TiranaFilmFestival1
- Vimeo: tiranafilmfest
- LinkedIn: Tirana International Film Festival
- TikTok: @tiranafilmfest

Teksa TIFF hyn në edicionin e tij të 24-t, festivali vijon misionin e tij për të promovuar ekselencën kinematografike, për të nxitur dialogun kulturor, për të mbështetur talentet e reja dhe për ta pozicionuar Shqipërinë si një pikëtakim të rëndësishëm për kinemanë ndërkombëtare.